VENDIM
Nr. 152, datë 28.5.2026

MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 91, DATË 2.4.2026, "MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË 'DION ENERGJI' SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK, ME KAPACITET TË INSTALUAR 2 mw"

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; si dhe të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.5.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1693 prot., datë 26.5.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës "Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 91, datë 2.4.2026, 'Mbi licencimin e shoqërisë 'DION Energji' sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2 mw'",

konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë "DION Energji" sh.p.k.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 91, datë 2.4.2026 vendosi të licencojë shoqërinë "DION Energji" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier, për një afat 30-vjeçar.
- Në pikën 2 të këtij vendimi përcaktohet se shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda datës 15.5.2026, ndërsa në pikën 4 përcaktohet se ky vendim është objekt rishikimi, në rast të plotësimit/mosplotësimit të kushtit të pikave 2 dhe 3 të këtij vendimi.

2. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Për vendimin e sipërcituar, shoqëria është njoftuar me shkresën e ERE-s me nr. 667/8 prot., datë 20.4.2026, me anë të së cilës i janë sjellë në vëmendje dhe kushtet e vendimit.
- Nga të dhënat që ERE disponon, në kuadër të raportimeve mujore të depozituara nga shoqëria "Furnizuesi i Tregut të Lirë" (FTL) sh.a., rezulton se shoqëria "DION Energji" sh.p.k. ka hyrë në operim në muajin prill 2026, pra brenda afatit të përcaktuar në vendimin e Bordit të ERE-s.
- Në këto kushte, vlerësohet se pika 2 e vendimit nr. 91/2026, duhet të shfuqizohet.

3. Nevoja për ndryshimin e vendimit

- Në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", parashikohet se një akt administrativ mund të ndryshohet, shfuqizohet apo anulohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë për ta nxjerrë atë.
- Në vijim të shfuqizimit të pikës 2, të vendimit nr. 91/2026, vlerësohet i nevojshëm edhe ndryshimi i pikës 4 të këtij vendimi, si vijon: "Ky vendim është objekt rishikimi në rast të përmbushjes apo mospërmbushjes së kushtit të përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi, , si dhe në rast të depozitimit të dokumenteve të ndryshme që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.".

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 91, datë 2.4.2026, si vijon:

a) Pika 2, e vendimi të Bordit nr. 91, datë 2.4.2026, shfuqizohet;

b) Pika 4, e vendimi të Bordit nr. 91, datë 2.4.2026, ndryshon dhe bëhet: “Ky vendim është objekt rishikimi në rast të përmbushjes apo mospërmbushjes së kushtit të përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi, si dhe në rast të depozitimit të dokumenteve të ndryshme që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.”.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “DION Energji” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqërinë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a., shoqërinë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sh.a. dhe shoqërinë “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike” (ALPEX) sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti